



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LICENSIMIT**

AN020420200001

Tiranë, më: 15.09.2020

**Vendimi 48**

**DEKLARATE MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

**Lëshimin e Deklaratës Mjedisore negative, për Zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:**

**Personi juridik:** SHOQËRIA KONCENSIONARE AYEN - ALB

**Nr. NIPT-i:** L72321029P

**Adresa e selisë:** Tiranë, Nj.B. Nr.2, Rruga Papa Gjon Pali i II-te, ABA Business Center, Kati 6, Nr.601

**Personi përgjegjës:** Fahrettin Amir Arman

Për të zhvilluar projektin “**Ndërtim HEC Kalivac**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”pika 15: “Diga dhe instalime të tjera, që janë projektuar për të penguar daljen e ujit ose për të depozituar ujin në mënyrë të përhershme, ku një masë e re uji që është penguar ose depozituar është mbi 10 milionë m<sup>3</sup>/ ditë;

**Vendndodhja:** Kalivac, mbi lumin Vjosa, Qarku Gjirokastër

**Fuqia e instaluar:** 111 MW

**Prodhim vjetor i llogaritur:** 366.62 GWh

*(Bashkangjitur Anex 1. Planvendosje, koordinata)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr.10440, date 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

*Refuzimi i kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse.*

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr.10440, datë: 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshte po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:**

*Drejtoritë teknike të ministries shprehin mendimin si më poshtë vijon:*

Subjekti nuk ka mbajtur parasysh sugjerimet në fazën e njoftimit. Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit Nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet:*

Sipërfaqja e kërkuar nuk shtrihet në zonë të mbrojtur.

### **2. Ministria ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse, si dhe shkallën e reflektimit të tyre;**

### **3. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore.

Problemet kryesor që u diskutuan ishin:

- Shpronësimet dhe cmimi i tokave e shtëpive që preken nga projekti, sidomos për 7 (shtatë) familje shumë afër zonës së digës.
- Përmbajtja e tokave dhe si rrjedhim të gjitha investimet e fermerëve vendas në të mbjella.
- Përdorimi i lëndëve plasëse gjatë fazës së ndërtimit, duke shkaktuar zhurma, pluhur etj, shumë shqetësuese për komunitetin
- Lumi i Vjosës është një nga lumenjtë e fundit më të egër të Europës.

### **4. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:**

- Në raportin e thelluar të VNM-së subjekti nuk ka mbajtur parasysh të gjitha sugjerimet e bëra në fazën e njoftimit për çështjet që duhet të trajtonte në raportin e thelluar të VNM-së, sa i takon menaxhimit të mbetjeve që do të gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, nuk janë përshkruar masat konkrete i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

- Lumi Vjosa është një nga lumenjtë e fundit të mëdhenj të egër në Evropë, i cili rrjedh i pandërprerë në gjatësinë prej 200 km në territorin shqiptar. Ndërtimi i veprës do të shkaktojë ndryshim të rrjedhës natyrore, për shkak të derivacioneve.
- Gjendja natyrore dhe vlerat e biodiversitetit të lumit Vjosa, janë ndër më të lartat në Ballkan, ku gjenden qindra gjallesa të reja, dy prej të cilave të panjohura më parë për shkencën. Zona ofron habitate tokësore dhe ujore për lloje shpendësh, gjitarësh, peshqishshtegëtarëtë kërcënuar. Zbatimi i projektit ndikon negativisht në të gjithë ekosistemin e vecantë të zonës, duke kërcënuar deri në zhdukje këto gjallesa.
- Bazuar në vlerat e zonës, lumi i Vjosës konsiderohet potencial i lartë për zhvillime alternativë, si ekoturizmi dhe bujqësia. Ndërtimi i HEC Kalivac do të sjellë pasoja të dëmshme në sektorin e turizmit dhe atë të bujqësisë në pellgun ujëmbledhës të Vjosës.
- Duke qënëse HEC Kalivac do të ndërtohet me digë, priten përmbytje të tokave dhe si rrjedhim edhe të të gjitha investimeve të banorëve të zonës në të mbjella, ku si burim kryesor jetik kanë bujqësinë, për vetë kushtet që ofron zona. Krijimi i një rezervuari përveç tokave bujqësore, prek edhe jetën e flores dhe faunes
- Gjithashtu ndërtimi i digës, për shkak të përmbytjes, kërcënon seriozisht rrugën e peshqve shtegëtarë sidomos në periudhën e shumimit të tyre.
- E gjithë rrjedha ujore e lumit Vjosa, është një faktor i rëndësishëm në krijimin e mikroklimave për zonën në fjalë. Zbatimi i projektit do të ndikojë negativisht në parametrat klimaterikë.
- Do të ketë ulje të cilësisë së ujit dhe ndryshime të vetive viziko-kimike të tij, duke ndikuar edhe në cilësinë e jetës së gjallesave ujore.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**

**EDISON KONOMI**

**MINISTRI**

**BLENDI KLOSI**

*Konceptoi:*

*Konfirmoi:*

*Miratoi:*

# 1. Aneks 1. Planvendosje

Kordinatat e Zones se Projektit

WGS 84		ALBANIAN 1986/GK4	
N 4023°57.86'';	E 1948°12.12''	4398538.971	4474669.948
N 4023°47.42'';	E 1948°2.49''	4398392.274	4474727.615
N 4023°57.81'';	E 1947°45.46''	4397902.235	4474678.596
N 4024°9.95'';	E 1947°57.20''	4398207.449	4476309.606

